



PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 02/07/2024

PRIMLJENO:

02/201



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 28.06.2024

Në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 14 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008), të nenit 27 par 27.2, lidhur me paragrafin 1 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.10/03 Prill 2019), Ligjit për Pyjet, Ligji nr.08/L-137, dt.09.03.2023, neni 11,12, Rregullores QRK-nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës neni 34 dhe 35 dhe Statutit të Komunës së Malishevës, nr.02/441, dt.14.05.2023, kërkesës nr.02/209, dt.21.05.2024, të parashtruar nga z.Naim Dobruna nga fshati LLozicë, KK-Malishevës,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datë 28.06.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Shpallet zonë me interes public për Komunën e Malishevës, për nevojat e përgjithsme publike "vendosja e lapidarit" në pjesën e njësisë kadastrale numr P-72310043-00119-6, zona kadastrale LLozicë, e evidentuar në emër të OTHPB "Ekonomia e Pyjeve" në Komunën e Malishevës, e cila është në pronësi dhe menagjim të Agjencionit Pyjorë të Kosovës, në kuadër të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
2. Shpallet zonë me interes publik, pjesët e njësive kadastrale si më poshtë;
- 2.1- Pjesa e njësive kadastrale me numër P-72310043-00119-6, me sipërfaqe prej 200 m² në vendin e quajtur "Arat nën Shtëpi, lloji i shfrytëzimit bujqësor, me kulturë kullosë e klasit 3, pjesë e pronës 1/1, pronësi të OTHPB "Ekonomia e Pyjeve" në pronësi dhe menagjimin e Agjencionit Pyjorë të Kosovës
3. Shpallja e njësive kadastrale të cekura sipas nenit 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet me qëllim të ligjshëm publik, për nevoja të përgjithshme, "vendosja e lapidarit" sipas kërkesës së palës, pas plotësimit të kritereve ligjore.

4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën kryetari i komunës, përmes drejtorisë për gjeodezi, kadastrë dhe drejtorisë për pronë.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: kërkesa e palës nr.02/209, dt.21.05.2024, certifikatat e pronësisë, kopjet e planit të njësisë kadastrale të cilat me këtë vendim janë shpallur zona me interes të përgjithshëm publik.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

-U vendos nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, me datë, 28.06.2024.-

Vendimi ju dërgohet:

- 1.MAPL-së,
- 2.Drejtorive të KK-së
- 3.Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit

